

**KONTRATE SHITJE KUOTASH (KAPITALI)**  
**TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**TECHSTAR shpk NUIS M31917037A**

Sot me date 30/08/2023, palet si me poshte perpiluan kete kontrate shitje kuotash kapitali:

**PALA SHITESE**

**z.Fatjon Kurushi**, shtetas shqiptar, atësia Behaudin, lindur më 12.04.1989, në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit (karte identiteti) me nr. Personal **I90412078S** madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ne cilesine ortakut me 100% te shoqerise me emertimin TechStar shpk regjistruar ne Q.K.R. me NUIS **M31917037A** Zona Kadastrale nr. 3292, Numri I Pasurisë: 153/144+1-14, Tiranë, Selitë, Nr.ap: 14.

**PALA BLERESE**

**Z. Orhan Kurushi**, shtetas shqiptar, atësia Bahri, lindur më 07.12.1990, në Fushë Krujë, banues në Tirane, mbajtës i letërnjoftimit (karte identiteti) me nr. Personal J01207074S, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, pranuesi i kuotave te shoqerise TechStar shpk regjistruar ne Q.K.R. me NUIS **M31917037A** Zona Kadastrale nr. 3292, Numri i Pasurisë: 153/144+1-14, Tiranë, Selitë, Nr.ap: 14.

**TE DHENAT PARAPRAKE**

Sipas Ekstraktit te Regjistrimit Tregetar, eshte regjistruar subjekti TechStar shpk ne Q.K.R. me NUIS **M31917037A** me adrese ne Zona Kadastrale nr. 3292, Numri I Pasurisë: 153/144+1-14, Tiranë, Selitë, Nr.ap: 14.

Kjo shoqeri eshte e perbere nga ortaku i vetem i kuotave **z.Fatjon Kurushi** zoterues me 100% te kuotave, me 1 kuote qe perben 100% te kapitalit te shoqerise, e cila eshte ne vleren 100.000 (njqind mije) leke.

Sipas Vendimit Nr.02/2023 te Ortakeve te Shoqerise TechStar shpk eshte vendosur shitja e 100% te kapitalit ose 1 nje kuote me vlere 100.000 lek e shoqerise nga **z. Fatjon Kurushi** tek

**z. Orhan Kurushi.**



## OBJEKTI

Shitja e 1(nje) kuote e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise, e cila eshte ne vleren 100,000 (njeqind mije) leke, duke ja kaluar pales blerese **z.Orhan Kurushi**.

## KALIMI I KUOTAVE

Me perpilimin e kesaj kontrate shitje kuotash (kapitali) te Shoqerise TechStar shpk regjistruar ne Q.K.R. me NUIS **M31917037A**, ortaku **z.Fatjon Kurushi** e humbet kete cilesi dhe ortak i vetem i shoqerise behet bleresi i kuotave **z.Orhan Kurushi**, i cili do kete ne zoterim 100% te kuotave te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar.

## DETYRIMET E PALEVE

Pala shitesese garanton palen blerese, se kuotat e zoteruara prej tij jane te lira dhe mbi ato nuk rendon barre siguruese.

Pala blerese duhet te regjistroje kalimin e kuotës, sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Emertimi i shoqerise nuk do te ndryshoje.

## LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve te kesaj kontrate, jane objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

## INTERPRETIMI I KONTRATES

Kontrata duhet te interpretohet ne mirebesim nga palet.

Kontrata ose kushtet e saj interpretohen ne kuptimin ne te cilin mund te kete ndonje efekt dhe jo ne ate, sipas te cilit nuk do te kishte ndonje efekt.

## BAZA LIGJORE

Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 „ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“, si dhe ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Neni 761 e vijues i Kodit Civil.

Sa me lart u perpilua kjo Kontrate Shitje Kuotash (Kapitali) te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ne 4 (kater) kopje te njejta, dhe nenshkruhet prej paleve.

**SHITESI**

**z.Fatjon Kurushi**



**BLERESI**

**z.Orhan Kurushi**

